

PËR SHPALLJEN E 1 (NJË) VENDI VAKANT PËR POZICIONIN SPECIALIST NE
SEKTORIN E LEXIMIT DHE BIBLIOTEKAVE NE QENDRËN KOMBËTARE TE LIBRIT
DHE LEXIMIT

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

- a) Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në fushën e shkencave filologjike me diplomë “Master profesional ose shkencor”, në Shqipëri, ose studimet universitare në fushën e shkencave filologjike jashtë vendit dhe të ketë marrë diplomë të njësuar, sipas legjislacionit në fuqi për njësimin e diplomave;
- b) Ndaj tij të mos jetë nisur procedim penal dhe të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale;
- c) Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;
- d) Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur dhe për të punuar në grup.

Disa nga Detyrat e punëmarrësit

- Përgjigjet për zbatimin e programeve të zhvillimit të leximit dhe bibliotekave.
- Harton programe pune për realizimin e zhvillimit të leximit dhe bibliotekave.
- Zbaton detyrat e ngarkuara për realizimin e programeve të leximit dhe bibliotekave.
- Ofron mbështetje teknike në funksion të përmbushjes së qëllimit të ekzistencës.
- Raporton për përmbushjen e detyrave funksionale.

Kandidati i interesuar duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

- Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;
 - Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
 - Kopje të dokumenteve: diplomë, letërnjoftim dhe librezë pune (originale ose të noterizuara);
 - Dëshmi penaliteti;
 - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
 - Çdo dokumentacion tjetër, që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.
- Aplikimet duhet të dorëzohen brenda datës 21 korrik 2023, pranë Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, zyra e protokollit, nga e hëna–të premte, ora 08:00–16:30, ose nëpërmjet postës elektronike, në adresën: info@qkll.gov.al, që konfirmon marrjen e aplikimit përkatës